

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE DHE I SPORTIT**



PUNIMI I DIPLOMËS – MASTER

**NDIKIMI I DIMENSIONEVE TË VOLUMIT TRUPOR DHE FORCËS
EKSPLOZIVE NË EKZEKUTIMIN E DISA NDRYSHOREVE
SITUACIONALE NË LOJËN E HENDBOLLIT**

MENTORI:
Dr. Ass. Afrim Koca

KANDIDATI:
Meriton Arifi

Prishtinë, nëntor, 2016

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	3
1.2. PASQYRA E HULUMTIMEVE TË GJERTANISHME	6
1.2.1 <i>Pasqyra e hulumtimeve të autorëve nga bota.....</i>	<i>7</i>
1.2.2. <i>Pasqyra e hulumtimeve të autorëve nga Kosova.....</i>	<i>10</i>
2. QËLLIMI I PUNIMIT	12
3. HIPOTEZAT THEMELORE	13
4. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	14
4.1. <i>MOSTRA E ENTITETIT</i>	<i>14</i>
4.2. <i>MOSTRA E NDRYSHOREVE</i>	<i>14</i>
4.2.1. <i>Ndryshoret e volumit trupor</i>	<i>14</i>
4.2.2. <i>Ndryshoret motorike të forcës eksplozive</i>	<i>15</i>
4.2.3. <i>Ndryshoret motorike situacionale</i>	<i>15</i>
4.3. <i>KUSHTET E MATJES</i>	<i>16</i>
4.4. <i>TEKNIKA E MATJES</i>	<i>17</i>
4.4.1 <i>Teknika e matjes të parametrave antropometrik.....</i>	<i>17</i>
4.4.2 <i>Teknika e matjes të parametrave motorik të forcës eksplozive.....</i>	<i>22</i>
4.4.3 <i>Teknika e vlerësimit të parametrave lëvizore situacionale.....</i>	<i>27</i>
4.3. <i>PËRPUNIMI I REZULTATEVE.....</i>	<i>31</i>
5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI.....	32
5.1. <i>ANALIZA DESKRIPTIVE</i>	<i>32</i>
5.1.1 <i>Përshkrimi i parametrave themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike të masës dhe vëllimit trupor, motorike të forcës eksplozive dhe motorike situacionale</i>	<i>32</i>
5.2. <i>MATRICA E INTERKORELACIONIT NDËRMJET NDRYSHOREVE TË MASËS DHE VOLUMIT TRUPOR, FORCËS EKSPLOZIVE DHE MOTORIKE SITUACIONALE.....</i>	<i>47</i>
5.3 <i>ANALIZA REGRESIVE E PARAMETRAVE TË VOLUMIT TRUPOR MOTORIKE TË FORCËS EKSPLOZIVE ME ATA SITUACIONAL.....</i>	<i>49</i>
5.4. <i>VËRTETIMI I HIPOTEZAVE.....</i>	<i>57</i>
6. PËRFUNDIMI	58
7. LITERATURA	60

1. HYRJE

Hendbolli si sport mjaft atraktiv për adhuruesit e saj, kohëve të fundit ka shënuar rritje të mëdha në disa drejtime, si në aspektin e përgaditjes fizike ashtu edhe asaj tekniko-taktike. Por, kërkesat dhe synimet për të ngritur në një nivel edhe më cilësor duhet që në vazhdimësi të punohet në aspektin e ngritjes profesionale.

Hendbolli bashkëkohor posedon lëvizje komplekse si në aspektin tekniko –taktike, ashtu edhe në atë të përgatitjes së lartë fizike, me aksione të rrjedhshme dhe të shpejta, pastaj me gjuajtje të forta efektive të perfeksionuara.

Në ndeshjet të cilat zhvillohen tani në lojën e hendbollit është ngritur intensiteti i lojës dhe kërkesat e lojës janë ngritur, dhe në momente të caktuara situacionale këto i japin lojës së hendbollit një dinamikë dhe shkëlqim që zgjon kërshërinë e sportistëve dhe interesim të madh në mesin e nxënësve nëpër shkolla.

Edhe në vendin tonë duhet të punohet jo vetëm me klube por edhe nëpër shkolla fillore dhe të mesme e sidomos duhet një punë dhe angazhim më i madh i profesorëve të Edukatës Fizike dhe Sportit, sepse në këtë mënyrë rritet interesimi dhe masivizimi për sportin e hendbollit, mund të themi se pa sport shkollor nuk ka sport kulmues.

Loja e hendbollit për dallim nga aktivitetet komplekse kineziologjike tjera karakterizohet me përqendrim maksimal, reagim të shpejt, pozita në qëndrimin statik, forcë të madhe eksplozive, dhe me precizitet të lartë. Këto kërkesa të lojës në volejball, përpos që kërkojnë nga lojtarët përgatitje të lartë kondicional, kërkojnë që hendbollistët të kenë karakteristika antropometrike që i përgjigjen lojës së hendbollit. Këtu përherë mendohet në lartësinë dhe peshën e trupit. Domethënë, karakteristikat morfologjike të hendbollistëve janë ato pjesë të statusit antropologjik që janë më të dukshme dhe që kontribuojnë në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha dimensioneve tjetër antropologjike.

Rëndësia e ndërtimit të trupit për sportet kulmore nuk është e definuar në tërësi si parakusht për arritjen e rezultateve të larta në sportet e kategorive të larta. Prap se prap, hulumtimet kanë treguar se sportistët e suksesshëm tregojnë ngjashmëri në ndërtimin dhe në raportin e masës pasive trupore dhe aktive trupore, dhe këto shprehen më shumë duke përparuar dhe duke arritur kategori gjithë e më të larta në e kategorive të larta. Hendbollistët e përfshirë në hulumtim si sportist të rangut të lartë, shikuar në aspektin morfologjik paraqiten si grup

homogjen. Kjo len të kuptojmë se tretmanët kineziologjike gjatë përgatitjes kondicionale të loja e hendbollit gjatë fazës përgatitore dhe fazës së garave ka rëndësi të veçantë.

Nga të gjitha karakteristikat antropologjike ku bëjnë pjesë veçoritë morfologjike, konative, aftësive motorike, kognitive, funksionale disa karakteristika psikologjike dhe sociologjike, dy karakteristikat antropologjike; statusi morfologjike dhe motorik janë një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në lojën e hendbollit. Faza e rritjes dhe zhvillimit të organizmit është periudha më e ndjeshme ndaj ndikimit të aktiviteteve të ndryshme fizike që shkaktojnë ndryshime të shumëfishta pozitive në karakteristikat morfologjike dhe në përmirësimin e aftësive motorike të cilat kanë një rëndësi të veçantë në arritjen e suksesit në lojën e hendbollit, me kusht që këto karakteristika morfologjike dhe aftësi motorike të jenë të aplikuara në mënyrë të drejtë.

Shumica e aftësive motorike fitohen dhe zhvillohen kryesisht në periudhën e fëmijërisë. Në këtë periudhë të zhvillimit ndërtohet dhe zhvillohet struktura e hapësirës motorike, ndërsa pas periudhës së pubertetit (14 – 16 vjeçare), fillon të stabilizohet (Metikoš me bp., 1974; Kurelič me bp., 1975; Bala, Kiš dhe Popovič, 1996).

Në këtë fazë të zhvillimit me sukses i përvetësojnë elementet e teknikës sportive duke i ekzekutuar me një intensitet më të lartë, dhe se në këtë periudhë është e nevojshme një proces stërvitor më i avancuar.

Nga, gati të gjitha karakteristikat antropologjike ku bëjnë pjesë veçoritë konative, aftësive kognitive, funksionale disa karakteristika psikologjike dhe sociologjike, dy karakteristikat antropologjike; statusi morfologjike dhe motorik janë një nga faktorët më të rëndësishëm stimulues dhe me veprim restriktiv në paraqitjen dhe, natyrisht, zgjedhjen dhe suksesin në hendboll.

Rritja dhe zhvillimi i shpejtë i organizmit është periudha më e ndjeshme ndaj ndikimit të aktiviteteve të ndryshme fizike që shkaktojnë ndryshime të shumëfishta në karakteristikat morfologjike dhe në përmirësimin e aftësive motorike.

Në përputhje me rrethanat, është e arsyeshme të thuhet se karakteristikat antropometrike dhe aftësitë motorike adekuate të sportistëve mundësojnë që të arrihen rezultate të favorshme në disiplinat e angazhuara

Identifikimi i talenteve dhe zhvillimi i tyre është bërë një komponentë e rëndësishme e programeve sportive vitale në shumë shtete të zhvilluara. Në formimin e tipareve

antropologjike të një popullate ndikim parësor ka faktori gjenetik, por nuk duhet lënë anash ndikimin e faktorëve të jashtëm, pra faktorët ekologjik. Vendet e zhvilluara fillojnë me seleksionimin dhe perzgjedhjen e një kombëtareje duke zbatuar planprograme të hartuara nëpërmjet Institutit shtetror për zhvillimin e sportit (gjë e cila tek ne mungon, për momentin nuk aplikohet). Zhvillimi morfologjik së bashku me aftësitë tjera antropologjike kanë rrol të rëndësishëm në perzgjedhjen e të rinjëve, ku është i njohur fakti se rezultate më të larta arrijnë ata sportist me karakteristika të vaçanta dhe më të mira nga këto dy lami të lartëpërmendura. Nga literatura e shqyrtuar hasim se të ata persona që kanë predispozita specifike antropometrike dhe aftësi motorik më të mira, kanë një shkallë më të lartë të suksesit në sportin e hendbollit, andaj duhet bërë zgjedhja e dimensioneve të nevojshme antropometrike e motorike si dhe duhet bërë zgjedhja e operatorëve adekuat më qellim të transformimit - orjentimit drejt realizimit të rezultateve cilësore në lojën e hendbollit.

Loja e hendbollit për dallim nga aktivitetet komplekse kineziologjike tjera karakterizohet me përqendrim maksimal, reagim të shpejt, pozita në qëndrimin statik, forcë të madhe eksplozive, dhe me precizitet të lartë. Këto kërkesa të lojës në volejball, përpos që kërkojnë nga lojtarët përgatitje të lartë kondicionale, kërkojnë që hendbollistët të kenë karakteristika antropometrike që i përgjigjen lojës së hendbollit. Këtu përherë mendohet në lartësinë dhe peshën e trupit. Domethënë, karakteristikat morfologjike të hendbollistëve janë ato pjesë të statusit antropologjik që janë më të dukshme dhe që kontribuojnë në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha dimensioneve tjetër antropologjike (Kovač me bp. 1997).

Hulumtimet në fushën e kineziologjisë përherë janë të orientuara në zbulimin e faktorëve që ndikojnë në arritjen e rezultateve në lojën e hendbollit. Në fushën e morfologjisë dhe konstitucionit trupor te shumë autorë si cak i hulumtimit është përcaktimi dhe ndikimi i tyre në aftësitë motorike dhe motorike-situacionale e që janë parakusht për arritjen e rezultateve sa më të larta në lojën e hendbollit.

1.2. PASQYRA E HULUMTIMEVE TË GJERTANISHME

Si në shumë sporte tjera edhe në lojën e hendbollit, hulumtimet e karakteristikave antropometrike, motorike dhe motorike situacionale paraqesin detyrë kërkimore dhe shkencore si në hapësirën manifeste ashtu edhe në atë latente. Deri më tani janë bërë hulumtime të shumta pikërisht në këto hapësira ku është konstatuar se kanë ndikim të rëndësishëm në arritjen e rezultateve sportive në lojën e hendbollit. Tematikë studimore e hulumtimeve të deri tanishme nga autoret tanë janë të pakta dhe shumica e këtyre punimeve kanë analizuar parametrat themelore antropometrike, motorik dhe motorike situacionale te grupmoshat e ndryshme të fëmijëve si në shkolla të niveleve të ndryshme ashtu edhe në disa klube të hendbollit. Po thuaj se në të gjitha hulumtimet, autoret e ndryshëm vërtetojnë raportet tejet të rëndësishëm të karakteristikave antropometrike me ato motorike dhe motorike situacionale.

Në këtë nënkapitull do të paraqiten hulumtimet e gjertanishme sipas rëndësisë që e kanë në ndikimin e tyre në lojën e hendbollit, edhe atë së pari do të paraqiten hulumtimet në fushën e antropometrisë dhe të psikomotorikës të autorëve të huaj dhe pastaj të autorëve Kosovarë.

1.2.1 Pasqyra e hulumtimeve të autorëve nga bota

Punimet e autorëve të jashtëm janë të përshkruar sipas viteve të publikimit.

Pavlin, Shimenc, Delija, (1982), në mostrën prej 54 studentëve të Fakultetit të Kulturës Fizike, të orientuar në hendboll kanë aplikuar baterinë prej 22 testeve situacionale në hendboll. Në këtë rast kanë fituar disa faktorë që janë definuar si: precizitetit situacional, shpejtësia e lëvizjes me top, shpejtësia e lëvizjes pa top dhe forca eksplozive e gjuajtjes së topit të hendbollit. Pra, janë vërtetuar karakteristika të kënaqshme metrike të testeve me përjashtim të testeve të precizitetit.

Kovač, Kovač, (1997) në një mostër prej 144 hendbollistëve me cilësor (lojtar të ligës së parë dhe dytë Federale) janë vërtetuar korrelacionet midis karakteristikave morfologjike dhe aftësive të veçanta motorike. Karakteristikat morfologjike janë marrë duke matur 12 ndryshore antropometrike, dhe karakteristikat specifike motorike u vlerësuan në bazë të 17 testeve situacionale-motorike. Në bazë të analizës kanonike të korrelacionit është përcaktuar një palë i faktorëve kanonik, gjë që shpjegon strukturën e marrëdhënieve midis sistemit të karakteristikave morfologjike dhe aftësive të veçanta motorike-specifike në kuptimin e mëposhtme: 1. zhvillimi më i mirë e dimensioneve morfologjike (longitudinale dhe transversale dimensioneve të skeletit, si dhe masës dhe vëllimin të trupit) mundësojnë një avantazh të rëndësishëm gjatë shprehjes së aftësive të veçanta motorike te hendbollistët; 2. Nga sistemi i ndryshoreve morfologjike prediktore ndikim të veçant dhe të rëndësishëm mbi aftësitë e përgjithshme të caktuara motorike te hendbollistët ka madhësi e shuplakës.

Oxyzoglou, Ore, Rizos, (2004), Departamenti i Kulturës Fizike dhe Shkencës Sportive, Aristoteli Universitetin i Selanikut, Serres, Greqi, në hulumtimin e tyre kanë vërtetuar dallimin në disa karakteristika antropometrike dhe motorike në mes hendbollistëve profesional të Sërbisë dhe Greqisë e që ka ndikue dukshëm në paraqitjen e sa më të mirë dhe në rezultatin përfundimtar.

Bojić (2005), në hulumtimin e tij që ka pas për qëllim vërtetimin e lidhshmërisë së karakteristikave antropometrike dhe aftësive bazike motorike te hendbollistët ka arritur në përfundim se ekziston në korelacion i rëndësishëm statistikor në mes karakteristikave antropometrike dhe aftësive bazike motorike te hendbollistët.

Čavala (2006) studimi është kryer në mostrën prej 53 hendbollistëve kulmore të republikës së Kroacisë, me qëllim të diagnostikimit të aftësive të tyre latente morfologjike-motorike, dhe të vërtetohet struktura dhe raporti i këtyre strukturave të fituara nga ndryshoret manifeste, për të vlerësuar efektivitetin në lojën e hendbollit. Me një seri të analizave të regresionit janë vërtetuar raportet në mes dimensioneve bazike motorike latente si prediktor dhe secilës ndryshore kriterike, dhe është vërtetuar ekzistenca korrelacioneve të rëndësishme ndërmjet tyre. Për të shpjeguar relacionet të dimensioneve morfologjike dhe motorike dhe një sërë ndryshoreve situacionale janë fituar katër palë rrënjë kanonik. Struktura kanonike e parë tregon ndikimin pozitiv faktorëve të agjilitetit dhe ndikimit aftësisë për të lëvizur shpejt pa top. Pastaj, në faktorin e dytë latent theksohet lidhje e faktorit morfologjike dhe motorik të dimensioneve transversale të shuplakës dhe forcës eksplozive të tipit të kërcimit me ndryshoret kriterike të precizitetit dhe manipulimit me topin hendboll. Struktura e çiftit të tretë dhe të katërt të rrënjëve kanonike tregon korrelacion midis aftësive motorike të shpejtësisë të tipit sprint dhe ndryshores motorike situacionale shpejtësisë së lëvizjes me top, dhe çiftit të katërt ndikimit të forca eksplozive të tipit të hedhjes, kërcimeve, agjilitetit, shpejtësia e frekuencionit të lëvizje dhe forcës së hedhjes së topit të hendbollit.

Me një seri të analizave të regresionit janë vërtetuar korelacionet mes dimensioneve morfologjike dhe motorike latente si prediktorë dhe secilës ndryshore kriterike, dhe ka krijuar ekzistencën e marrëdhënive të rëndësishme, si dhe është vërtetuar raporti ndërmjet veti.

Primož, Šibila, (2006), në mostrën prej 36 lojtarëve të hendbollit, kanë analizuar aftësitë motorike të shpejtësisë së ekzekutimit (lëvizjet më intenzive) në lojën e hendbollit dhe kanë arritur në përfundim se këto aftësi kanë ndikim të rëndësishëm në efikasitetin e lojës së hendbollit.

Savic, Doder, (2006), në hulumtimin e tyre kanë përshkruar dallimet në karakteristikat antropometrike ndërmjet dy reprezentacioneve të femrave në hendbollit, asaj të vitit 1984 dhe 2001 të ish Jygosllavisë. Rezultatet tregojnë për ndryshime në parametrat e volumenit trupor dhe të indit dhjamor në favor të ekipes së vitit 1984. Hendbollistët e reprezentacionit të vitit 2001 në raport me vitin 1984 kanë pasur legen më të gjerë, perimetër më të madhë

të gjoksit, të nënllëres dhe kofshës, dhe më pak ind dhjamor nënlëkuror të ekstremiteteve të eperme.

Bojić, Đurašković, Mladenović-Ćirić, Jovanović, (2007), në hulumtimin „Ndryshimet e disa karakteristikave antropometrike, aftësive bazike motorike dhe specifike motorike te hendbollistët e rin“ në mostrën prej 200 hendbollistëve të selekcionuar të moshës 12 dhe 13 vjeçare kanë vërtetuar ndryshimet e karakteristikave antropometrike dhe motorike nën ndikimin e procesit stërvitor gjashtëmujore.

Živković, Goranović, Marković, Branković, (2010), në studimin e tyre të kryer në një mostër prej 50 hendbollistëve të rinj ri të moshës 11 dhe 12 vjeçare ka aplikuar 10 ndryshore antropometrike dhe tri teste për përcaktimin e forcës eksplozive. Rezultatet e këtij studimi tregojnë se në mes karakteristikave antropometrike si sistem prediktor, dhe rezultateve të forca shpërthyes ose eksplozive, si ndryshore kriterike, ekzistojnë korrelacion të rëndësishëm statistikor kanonik, që nënkupton se ekzistojnë pojekcione të larta të karakteristikave morfologjike dhe forcës eksplozive në faktorin kanonik.

Demir, Stanković, (2007), në mënyrë që të fitojnë njohuri më të plota teorike të nevojshme për praktikën e sportit të hendbollit në Bosnjë dhe Hercegovinë që përzgjedhjen e lojtarëve të ardhshëm kulmor në hendboll ta realizojnë në popullsinë që kishte vonesa të dukshme zhvillimor për shkak të kushteve të luftës, ky hulumtimi ka për qëllim që të kërkoj përgjigje komplekse rreth pyetjes së korrelacionit ndërmjet dimensioneve morfologjike dhe aftësive situacionale-motorike që përcaktojnë zhvillimin e tyre integral dhe sigurojnë kushte për zhvillimin dhe përsosjen e të rinjve kulmor në hendboll.

1.2.2. Pasqyra e hulumtimeve të autorëve nga Kosova

Punimet e autorëve nga Kosova janë të paraqitura me sa vijon:

Zeqa (2004) ka bërë hulumtim me qëllim që të konstatohen disa karakteristika antropometrike dhe motorike me testet motorike-situacionale te hendbollistët e ligës së parë të Kosovës në hapësirën manifeste dhe latente.

Koca (2009) Në hulumtimin e tij me temën: "Relacionet dhe ndryshimet në hapësirën antropometrike, funksionale dhe aftësive lëvizore bazike dhe lëvizjeve situacionale ndërmjet hendbollistëve (juniorë) të superligës dhe ligës së parë të kampionatit të kosovës në hendboll" janë vërtetuar relacionet në hapësirën manifeste dhe janë identifikuar faktorët latent duke e aplikuar analizën faktoriale dhe dallimet dhe anë të T-testit.

Mullabaz (2011) me qëllim të vërtetimit të objektivit primar të punimit i cili është mbështetur në vlerësimin e rritës dhe zhvillimit të popullatës rinore shkollore të ciklit të lartë edhe atë në zhvillimit biologjik gjatë periudhave të caktuara kohore dhe ndikimit të disa aftësive motorikë bazike dhe atyre motoriko-situacionale të nxënësve ka përfshirë mostrën e të testuarve prej 240 nxënësve të dy gjinive. Rezultatet e fituara tregojnë se gjatësia e shuplakës së dorës dhe gjerësia e saj nuk janë në korelacion me testet situaciono-motorike të lojës së volejbollit. Kjo nuk do të thotë se nadhësia e shuplakës së dorës nuk ka ndikim në suksesin e lojës në hendboll. Këtë korelacion të pëndësishëm të ndryshoreve antropometrike me testet situacionale duhet kërkuar në ndryshimet në zhvillimin morfologjik të rinisë si dhe në objektivitetin e matjeve. Dallimet në mes të nxënësve të dy gjinitë në zhvillimin morfologjik, motorik dhe motoriko-situacional tregojnë për ndryshime individuale të individve gjatë fazes së rritjes e që i përkasin faktorit gjenetik.

Hetemi (2014) në punimin "Dallimi në mes nxënësve dhe nxënësve të angazhuar në seksionin e hendbollit në disa parametra antropometrik dhe motorik bazike" SI Qëllimi parësor kishte që të përcaktohet dhe vërtetohet dallimi në mes nxënësve që i u janë nënshtruar seancave stërvitore si orë shtesë në kuadër të seksionit shkollor të hendbollit në ndryshoret antropometrike dhe motorike bazike. Në këtë punim (hulumtim) janë përfshirë 30 nxënës të klasave të dhjeta të moshës 16 vjeçare që kanë pasur vetëm orë të rregullta të edukatës fizike dhe 30 nxënës të klasave të dhjeta të moshës 16 vjeçare që janë nënshtruar seancave stërvitore si orë shtesë në kuadër të seksionit shkollor të hendbollit

krahas orëve të rregullta pranë shkollës së mesme teknike SHMT "Anton Qeta" nga Skenderaj. Përpunimi i rezultateve tregon se grupet e nxënësve sa i përket parametrave antropometrik dallohen në gjatësinë e krahut dhe indin dhjamor nën lëkuror ku nxënësit e përfshirë në seancat stërvitore dy here në javë kanë pasur gjatësi të dorës më të madhe dhe vlera të indit dhjamor nën lëkuror më të ulëta. Sa i përket aftësive motorike nxënësit e përfshirë në seancat stërvitore dy here në javë kanë pasur rezultate më të mira në ndryshoret, vrapim në 30 m nga starti i lartë, tapingu me këmbë, tetëshe me përkulje, dhe në gjitha ndryshoret e karakterit të forcës eksplozive (testet me medicinball).

Koci (2014) hulumtimin e ka zbatuar me qëllim të përcaktimit dhe vërtetimit të ndikimit të ndryshoreve antropometrike në realizimin e disa detyrave motorike specifike. Me qëllim të realizimit të këtij hulumtimi në këtë punim (hulumtim) janë përfshirë 30 nxënës të klasave të dhjeta të moshës 16 vjeçare. Nxënësit e përfshirë në hulumtim kanë qenë të gjinisë mashkullore dhe kanë qenë nxënës të shkollës së mesme teknike SHMT "Anton Qeta" nga Skenderaj. Në hulumtim janë aplikuar 9 ndryshore antropometrike: Lartësia e trupit, Gjatësia e krahut, Gjatësia e shuplakës, Gjerësia e shuplakës, Gjatësia e këmbës, Gjatësia e shputës, Peshja e trupit, Perimetri i krahut, Indi dhjamor nën lëkuror i barku dhe dy ndryshoret të precizitetit situacional, Gjuajtja nga vendi i 10 topave në portë 50x50cm nga 9 metra dhe Gjuajtja nga kërcimi i 10 topave në portë nga 9 metra. Për realizimin e qëllimit të hulumtimit është aplikuar analiza regresive. Rezultatet e fituara nga analiza regresive tregojnë se në ndryshoren ose Gjuajtjen nga kërcimi i 10 topave në portë nga 9 metra (GJK10P9M), ndikim të rëndësishëm statistikor nuk ka asnjë ndryshore antropometrike, pra gjithë koeficientët nga kolona (Beta) nuk janë të rëndësishëm $p > 0.05$. Kjo tregon se gjatë matjeve duhet me pas kujdes më të madhe dhe se saktësia e matjeve duhet me qenë në nivel, sepse gjatë përpunimit dhe interpretimit haset në vështërsi.

2. QËLLIMI I PUNIMIT

Njohurit mbi zhvillimin morfologjik të sportistëve te sportet ekipore duhet të paraqesin një ndër preokupimet kryesore të trajnerëve dhe stafit drejtues të ekipeve. Nga një pasqyrë e tillë varet edhe niveli shëndetësor, social dhe sportiv i një shoqërie.

Çdo hulumtim shkoncor në lëminë e kulturës fizike dhe sportit ka të bëjë me vërtetimin e zhvillimit dhe vlerësimit të karakteristikave antropologjike të cilat janë përgjegjës në arritjen e suksesit në sportin përkatës.

- Qëllimi kryesor i hulumtimit përveç që ka të bëjë me vlerësimin e karakteristikave antropometrike dhe motorike, ka edhe të vërtetoj ndikimin e volumit trupor dhe të aftësive të forcës eksplozive në ekzekutimin e disa testeve specifike apo situacionale në lojën e hendbollit.

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Në përputhje me qëllimin e punimit formulohen dhe parashtrihen këto hipoteza:

H₀₁ – Ndryshoret e volumit trupor, forcës eksplozive dhe atyre situacionale të aplikuara në këtë punim nuk do të kanë shmangie nga shpërndarja normale.

H₀₂ – Ndryshoret e volumit trupor, forcës eksplozive dhe atyre situacionale të aplikuara në këtë punim do të kenë koeficiente të korelacionit statistikisht të rëndësishme ndërmjet veti.

H₀₃ – Ndryshoret e volumit trupor dhe forcës eksploziv do të kenë ndikim të rëndësishëm statistikor në ekzekutimin e testeve situacionale në lojën e hendbollit.

4. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

4.1. MOSTRA E ENTITETIT

Popullata nga e cila do të nxjerret mostra për hulumtim për këtë punim është definuar si popullatë e nxënësve të moshës 17 vjeçare të shkollës së mesme, Gjimnazi “Zenel Hajdini” në Gjilan.

Në këtë hulumtim do të përfshihen gjithsej 40 nxënës të moshës 17 vjeçare Të Gjimnazit “Zenel Hajdini” në Gjilan të cilët kanë qenë aktiv në klubet e hendbollit apo në seksionin e hendbollit pranë kësaj shkolle. Matjet janë ekzekutuar gjatë muajit shkurt në sallën e edukatës fizike të kësaj shkolle.

Kushti i vetëm i përdorur gjatë përcaktimit të mostrës ka qenë: që nxënësit të jenë të përfshirë në seksione të hendbollit dhe në orët e rregullta të edukatës fizike dhe në ditën e matjes kanë qenë të shëndoshë (pa grip, ftohje...).

4.2. MOSTRA E NDRYSHOREVE

4.2.1. Ndryshoret e volumit trupor

Do të apikohen këto ndryshore antropometrike të volumit trupor

1. Peshë e trupit..... **APESHA**
2. Perimetri i gjoksit..... **APGJOK**
3. Perimetri i krahut..... **APKRAH**
4. Perimetri i kofshës..... **APKOFS**
5. Perimetri i nënë gjurit (kërcirit).....**APNGJU**

4.2.2. Ndryshoret motorike të forcës eksplozive

Për identifikimin e aftësive motorike do të aplikohen këta parametra motorik të forcës eksplozive:

1. Kërcim së gjati nga vendi**MKGJVE**
2. Kërcim së larti nga vendi**MKLAVE**
3. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e djathtë.....**MKLAKD**
4. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e majtë **MKLAKM**
5. Hedhja e topit medicinal mbi kokë..... **MHTMKO**

4.2.3. Ndryshoret motorike situacionale

Për identifikimin e aftësive motorike situacionale janë aplikuar këta parametra motorik situacional të lojës së hendbollit:

1. Gjuajtja e topit në mur brenda një minute **MSGJT1M**
2. Udhëheqja e topit me shpejtësi 40 metra**MSUT40M**
3. Udhëheqja e topit zigzag (sllalom) me shpejtësi 20 metra**MSUS20M**
4. Vrapim tri here rreth 9m me tri gjuajtje**MSV3GJ9**

4.3. KUSHTET E MATJES

1. Matjet antropometrike janë ekzekutuar në orët e para të pasdites.
2. Instrumentet matëse kanë qenë të punimit standard dhe kanë qenë të bazhuara së paku çdo ditë para matjeve.
3. Vendi ku janë ekzekutuar matjet ka qenë hapësira e mjaftueshme dhe e ndriçuar mirë, ndërsa temperatura e ajrit rreth 22°.
4. Në vendin ku janë ekzekutuar matjet (sallë e edukatës fizike) kanë qenë pesë matës, shkruesi i rezultateve dhe grupi prej pesë të testuarve (secili matës nga një të testuar të cilët janë zëvendësuar pas matjes).
5. Të testuarit para matjes kanë qenë zbathur dhe vetëm në brekë.
6. Në çdo të testuar, para matjes, janë përcaktuar dhe shënuar në mënyrë të saktë nivelet dhe pikat antropometrike të cilat kanë qenë në programin e matjeve.
7. Dimensionet e caktuara antropometrike çdo herë i ka matur i njëjti matës.
8. Rezultatet e matjes janë lexuar gjatë kohës deri sa testuesi ka matur, ndërsa personi cili i ka shkruar rezultatet, për ti kontrolluar i ka përsëritur rezultatet me zë të çartë.
9. Matjet e ekstremiteteve çift të trupit janë ekzekutuar në anën e majtë të trupit.
10. Matjet antropometrike janë përsëritur nga tri herë.

4.4 TEKNIKA E MATJES

4.4.1 Teknika e matjes të parametrave antropometrik

Matjet e parametrave antropometrik janë ekzekutuar sipas kësaj renditje:


1. Pesha e trupit – APESHA është matë me peshore transportabile të vendosur në sipërfaqe të rrafshët. I testuari, zbathur dhe në brekë vendoset në mesin e peshores dhe qëndron në drejtqëndrim. Atëherë kur akrepi në peshore nuk lëvizë, rezultati lexohet me saktësi prej 0,5 kg.

Foto 1. Pesha e trupit



2. Perimetri i gjoksit (APEGJO) – është matë me traken matëse plastike. Para matjes i testuari është i zbathur, në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Traka matëse mbështjellët rreth gjoksit në një pozitë horizontale ndaj boshtit të trupit, duke kaluar horizontalisht nëpër pikat e lidhjes së brinjëve 3. dhe 4. për kockën e gjoksit. Rezultat i matjes lexohet atëherë kur kafazi i kraharorit është në pozitë mesatare (në fund të ekspiriumit normal, respektivisht, në pauzë ndërmjet inspirimit dhe ekspirimit). Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm

Foto 2. Perimetri i gjoksit (APEGJO)



3. Perimetri i krahut (APKRAH) – është matë me traken matëse prej plastike. Para matjes i testuari është i zbathur dhe në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Traka matëse mbështjellët rreth krahut të majtë (pjesës më të trashë) në boshtin e tij në nivel i cili i përgjigjet mesit ndërmjet akromionit dhe olekranonit. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 3. Perimetri i krahut (APEKRA)



4. Perimetri i kofshës (APKOFS) – është matur me shirit milimetrik. I maturi qëndron në këmbë me gjymtyrë të poshtme diç të larguara. Shiriti vendoset në të tretën e sipërme të kofshës (gjerësia më e madhe). Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

Foto 4. Perimetri i kofshës (APK)FS)



5. Perimetri i nën gjurit drejtqëndrim(APENGJ) –(ulur në arkën suedeze) është matë me traken matëse gjysmë plastike. Para matjes i testuari është i zbathur dhe në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim. Traka matëse mbështjellët rreth pjesës së nën gjurit të majtë (pjesës më të trashë) në boshtin e tij në nivel i cili i përgjigjet mesit ndërmjet zogut të këmbës dhe pjesës së epërme të tibies. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 5. Perimetri i nëngjurit apo kërcirit (AONGJU)



4.4.2 Teknika e matjes të parametrave motorik të forcës eksplozive

Ndryshoret të forcës eksplozive janë ekzekutuar sipas kësaj renditje:

1. Kërcim së gjati nga vendi – MKGJVE

Instrumentet: Metri metalik, shtegu për vrapim kërcim së gjati.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari vendoset me shputa në dysheme, në fytyrë nga drejtimi i kërcimit.

Realizmi i detyrës: I testuari në përkulje të vogël në gjunjë duke e shfrytëzuar edhe hovin e krahëve, realizon kërcimin me të dy këmbët para. Detyra përsëritet tri herë, ndërkaq shënohet rezultati më i mirë.

Vlerësimi: Shënohet rezultati i kërcimit më të gjatë nga vendi i shtytjes deri të gjurmët e pjesës së pasme të shputave në saktësi 1 cm.

Udhëzime të testimit: Kërcimi përsëritet nëse i testuari kërcen në vend para kërcimit para, nëse kërcimi realizohet në një këmbë, nëse pas rënies mbështetet prapa në duar etj.

Foto 6. Kërcim së gjati nga vendi – MKGJVE



2. Kërcim së larti nga vendi – MKLAVE

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjerësi të legenit. I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht , kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjës së parë, i testuari kërcen vertikalisht në lartësi (tre tentime) lexohet rezultati më i mirë prej prekjës së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Realizimi i detyrës: I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjës së parë , i testuari kërcen vertikalisht në lartësi (tre tentime). lexohet rezultati më i mirë prej prekjës së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm. Rezultati shënohet me 1 cm.

Vlerësimi: lexohet rezultati më i mirë prej prekjës së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Udhëzime të testimit: Të testuarve udhëzimet iu janë dhënë gjatë demonstrimit

Foto 7. Kërcim së larti nga vendi – MKLAVE



3. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e djathtë – MKLKED

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjerësi të legenit.

Realizimi i detyrës: I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë, i testuari kërcen vertikalisht në lartësi me këmbën e djathtë (tre tentime). lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarve udhëzimet iu janë dhënë gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. E testuara bënë disa tentime provuese.

Foto 8. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e djathtë – MKLKED



4. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e majtë – MKLKEM

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjerësi të legenit.

Realizimi i detyrës: I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë, i testuari kërcen vertikalisht në lartësi me këmbën e majtë (tre tentime). lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarve udhëzimet iu janë dhënë gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. I testuari bënë disa tentime provuese.

Foto 9. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e majtë – MKLKEM



5. Hedhja e topit medicinal mbi kokë – MHTMKO

Instrumentet: topi medicinal i peshës 2 kg, metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për hedhjen e topit medicinal

- **Përshkrimi i detyrës:**

- **Pozita fillestare:** I testuari qëndron në pozitë të drejtqëndrimit, fytyrë nga drejtimi i shtytjes së topit medicinal, me këmbë të zgjeruara në nivel të kërdhokullave dhe mban topin me dy duar të shtrira lartë mbi kokë.

- **Realizimi i detyrës:** I testuari nga pozita e drejtqëndrimit me fytyrë nga drejtimi i shtytjes hedhë topin medicinal sa ma larg që është e mundur. Detyra përsëritet dy herë. I testuari qëndron në pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë dhe të shikohet rregullsia e hedhjes.

- **Vlerësimi:** Shënohet rezultati i hedhjes e shënuar me centimetra. Pika zero është në fillim të hedhjes, saktësia e matjes 0,5 cm.

- **Udhëzime të testuarit:** Të testuarve iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.

Foto 10. Hedhja e topit medicinal mbi kokë – MHTMKO



4.3.3 Teknika e vlerësimit të parametrave lëvizore situacionale

Ndryshoret motorike situacionale janë ekzekutuar sipas kësaj renditje:

1. Gjuajtja e topit në mur brenda një minute – MSGJT1M

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek. Topi i hendbollit me perimetër 56cm me peshe 450 gram , rekuizitat (shiriti metrik) për shënimin e gjatësisë dhe katrori 1 x 1 m në lartësi 1 m nga dyshemeje dhe në largësi prej 6 m nga .

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgatitet për gjuajtje pranë vijës për gjuajtje në drejttëndri.

Realizimi i detyrës: I testuari pa vrull dhe pa shpëputje nga vija e gjuajtjes , gjuan topin sa më shpejt në katrorin e vendosur në mur gjatësi prej 6 metrave.

Vlerësimi: Matet numri i gjuajtjeve të sakta të topit në katror brenda 1 minute.

Udhëzime: Të testuarit udhëzohen që ta përsërisin dy here gjuajtjen si gjuajtje provuese.

Foto 11. Gjuajtja e topit në mur brenda një minute –MSGJT1M



2. Udhëheqja e topit me shpejtësi 40 metra – MSUT40M

Instrumentet: Metri metalik e gjatësisë 40m vendosur në tokë, topi i hendbollit me perimetër 56cm me peshe 450 gram.

Përshkrimi i detyrës;

Pozita fillestare: I testuari vendoset me shputa para vijës për udhëheqje, me fytyrë nga drejtimi të udhëheqjes.

Realizmi i detyrës: I testuari merr hov duke e udhëhequr topin, realizon udhëheqjen, me një dorë. Detyra përsëritet tri herë, ndërkaq shënohet rezultati më i mirë.

Vlerësimi: Shënohet shpejtësia e udhëheqjes së topit të hendbollit me saktësi 0.1 sek.

Udhëzime të testimit: Udhëheqje përsëritet nëse i testuari udhëheq në mënyrë të pa rregullt.

Foto 12. Udhëheqja e topit me shpejtësi 40 metra – MSUT40M



3. Udhëheqja e topit zigzag (sllallom) me shpejtësi 20 metra – MSUS20M

Instrumentet: Metri metalik e gjatësisë 20m vendosur në tokë, topi i hendbollit me perimetër 56cm me peshe 450 gram dhe 9 tapa të vendosura në çdo 2 metra.

Përshkrimi i detyrës;

Pozita fillestare: I testuari vendoset me shputa para vijës për udhëheqje, me fytyrë nga drejtimi të udhëheqjes.

Realizmi i detyrës: I testuari merr hov duke e udhëhequr topin zigzag, realizon udhëheqjen, me një dorë. Detyra përsëritet tri herë, ndërkaq shënohet rezultati më i mirë.

Vlerësimi: Shënohet shpejtësia e udhëheqjes së topit të hendbollit me saktësi 0.1 sek.

Udhëzime të testimit: Udhëheqje përsëritet nëse i testuari udhëheq në mënyrë të pa rregullt.

Foto 13. Udhëheqja e topit zigzag (sllallom) me shpejtësi 20 metra – MSUS20M



5. Vrapim tri here rreth 9m me tri gjuajtje – MSV3GJ9

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek. Topi i hendbollit me perimetër 56cm me peshe 450 gram, porta dhe distanca nga porta 9 metra.

Përshkrimi i detyrës:


Pozita fillestare: I testuari përgatitet pranë vijës për start të ekzekutimit të detyrës, në pozitë të drejtqëndrimit. Vija e startit është te vija ku takohen vija e 9 metrave me vijën anësore. Në vijën e 9 metrave përballë vijës së 7 metrave vendosen në parket 3 rathë me diametër 1 metër dhe në distancë prej 1 metër larg njëri-tjetrit.

Realizimi i detyrës: I testuari ka për detyrë që nga vija e startit të merr topin dhe të udhëheqë sa më shpejtë që është e mundur, të hyj në rreth dhe ta gjuaj në portë, të vazhdojë vrapimin deri te vija tjetër anësore ku takohen vija e 9 metrave dhe ajo anësore dhe kështu të vazhdojë vrapimin pa ndërprerë derisa t'i kryej tri gjuajtjet me top në portë.

Vlerësimi: Në fletë testim rezultatet shënohen me saktësi prej 0.1 sek.

Udhëzime të testuarit. Të testuarit udhëzohen që ta përsërisin dy here gjuajtjen si gjuajtje provuese.

Foto 14. Vrapim tri here rreth 9m me tri gjuajtje – MSV3GJ9



4.3. PËRPUNIMI I REZULTATEVE

Sipas qëllimit të parashtruar dhe hipotezave të përpiluara aplikohen parametrat statistikore dhe metodat kuantitative të cilat vërtetojnë synimet dhe objektivat e këtij punimi. Duke marrë parasysh të gjitha këto fakte, për qëllimet e këtij hulumtimi do të zgjidhen procedurat për të cilat konsiderohet se korrespondojnë me natyrën e problemeve që hulumtohen.

Për çdo ndryshore antropometrike të volumit trupor, ndryshore motorike të forcës eksplozive dhe teste situacionale do të llogariten vlerat e mëposhtme:

1. Parametrat qendrore themelor dhe të shpërndarjes:

- Mesatarja aritmetikore (Ma)
- Devijimi standard (Ds)
- Vlera minimale (Min)
- Vlera maksimale (Max)

2. Lakorja e shpërndarjes ose e shpërndarjes është testuar me anë të koeficientit të asimetrisë („skjunis”), dhe shkalla e lakimit e majës së kurbës ("kurtozis").

3. Shpërndarja e rezultateve të fituara nga vlerësimi do të testohet me anë të metodës së Kolmogorovit-Smirnovit (K-S)

4. Raportet e ndërlidhjeve ndërmjet ndryshoreve të volumit trupor, forcës eksplozive dhe testeve situacionale në hapësirën manifeste, do të bëhet me anë të analizës bivariate të korelacionit sipas Pearsonit.

5. Për percaktimin e relacionit dhe ndikimit të ndryshoreve prediktore (ndryshoreve të volumit trupor dhe të forcës eksplozive) në ekzekutimin e testeve situacionale, gjegjësisht kritere (ndryshoreve situacional) do të aplikohet analiza regressive në hapësirën manifeste.

5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI

5.1. ANALIZA DESKRIPTIVE

5.1.1 Përshkrimi i parametrave themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike të masës dhe vëllimit trupor, motorike të forcës eksplozive dhe motorike situacionale


Në tabelën 1 është paraqitur analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike të masës dhe vëllimit trupor, motorike të forcës eksplozive dhe motorike situacionale te 40 nxënës të moshës 17 vjeçare të Gjimnazit “Zenel Hajdini” në Gjilan. Në këtë tabelë janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së lakores (Kurtosis – konveksitet) dhe shmangja nga distribucioni normal me anë të metodës së Kolmogorovit-Smirnovit (K-S)

Tabela 1. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike masës dhe vëllimit trupor, motorike të forcës eksplozive dhe motorike situacionale

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis	KS	SHW
APESHA	40	49.40	93.50	63.6407	7.95164	1.304	3.801	.176	.004
APGJOK	40	76.90	99.30	86.4125	6.11959	.515	-.723	.090	.055
APKRAH	40	22.10	32.20	25.8303	2.13462	.851	1.278	.200*	.089
APKOFS	40	36.10	61.50	49.7500	5.15926	.027	.671	.200*	.731
APNGJU	40	30.50	43.60	34.8800	2.73910	1.088	1.878	.200*	.025
MKGJVE	40	200.00	261.00	218.0500	15.17750	.894	.339	.085	.006
MKLAVE	40	33.70	65.00	45.1015	7.61375	.809	.400	.001	.007
MCLKED	40	27.00	48.00	36.0750	4.47436	.489	.366	.200*	.579
MCLKEM	40	23.00	41.00	32.6250	4.67227	.220	-.594	.096	.211
MHTMKO	40	570.00	950.00	737.8750	107.93450	.422	-.823	.010	.041
MSGJT1M	40	13.00	35.00	22.7500	5.25625	.460	-.620	.025	.078
MSUT40M	40	6.14	13.40	8.0308	1.68141	1.238	1.873	.043	.000
MSUS20M	40	7.93	15.40	10.7310	1.85809	.456	-.366	.031	.036
MSV3GJ9	40	12.20	20.30	15.5290	1.98644	.118	-.703	.110	.225


Mesatarja aritmetikore e ndryshores, Pesha e trupit (**APESHA**), (Tabela 1 dhe Histogrami 1) është 63,64 kg. Rezultati minimal (49.40 kg.) dhe ai maksimal (93.kg) i ndryshores, pesha e trupit tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes të testuarve në këtë ndryshore antropometrike, si dhe një anim të lehtë të rezultateve ka rezultatet më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Dallim i theksuar në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal tregon se animi dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë një asimetri të theksuar, dhe lakorja ka formë leptokurtike. Edhe pse vërehet se rezultatet nuk kanë shmangie nga distribucioni normal të vërtetuar me anë të testit Kolmogorovit-Smirnovit, testi i Shapiro-Wilkut tregon për një shmangie nga distribucioni normal.

Histogrami 1. Histogrami i ndryshorës antropometrike, Pesha e trupit (APESHA)




Mesatarja aritmetikore e ndryshores, Perimetri i gjoksit (**APGJOK**) (Tabela 1 dhe Histogrami 2) është 86,41 cm. Rezultati minimal (76.90 cm.) dhe ai maksimal (99.30 cm) i ndryshores, perimetri i gjoksit tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes të testuarve në këtë ndryshore antropometrike, si dhe një anim të lehtë të rezultateve ka rezultatet më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Dallim i theksuar në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal tregon se animi dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar, dhe lakorja ka formë platokurtike. Vërehet se rezultatet nuk kanë shmangie nga distribucioni normal të vërtetuar me anë të testit Kolmogorovit-Smirnovit dhe testit të Shapiro-Wilkut.

Histogrami 2. Histogrami i ndryshorë antropometrike s, Perimetri i gjoksit (APGJOK)




